



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMANIZIMIT

Nr. 1664/1 prot.

Tiranë më 02.11.2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi një Memorandum.

### MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”), ka administruar shkresën tuaj me nr. 6866/2 prot., datë 28.10.2022, përmes së cilës kërkohet mendim për “*Memorandumin e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar, Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Republikës Italiane dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë “Për Mbrojtjen e shtetasve fëmijë të pashoqëruar të dy vendeve respektive si dhe për Bashkëpunimin në Parandalimin dhe Luftën ndaj dukurisë dhe Veprave Kriminale që lidhen me të”*”.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, Zyra e Komisionerit vlerëson se, në tërësi përmbajtja e këtij Memorandumi implemeton standarde të larta të mbrojtjes së të dhënave personale. Reflektimi dhe më tej zbatimi i këtyre standardeve, merr një vëmendje të veçantë edhe për autoritetin tonë, veçanërisht kur midis të dhënave që do të përpunohen ka edhe të dhëna të subjekteve të të dhënave “fëmijë”.

Sugjerimet e Zyrës së Komisionerit i referohen kryesisht terminologjisë së përdorur në Memorandum dhe në Shtojcën 1, në mënyrë që teksti, përkufizimet dhe gjuha e përdorur në përmbajtje të këtij akti të njehsohet me Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar (në vijim “*Ligji*”), me qëllim shmangien e paqartësive që mund të krijohen.

Gjithashtu, në sugjerimet e propozuara Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë faktin se, Shqipëria shumë shpejt do të ketë një kuadër të ri rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale sipas “*acquis*” të Bashkimit Evropian, të përafuar tërësisht me Rregulloren e (BE) nr. 2016/679 “*Për mbrojtjen e personave fizikë lidhur*”.

me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave” i cili parashikon standarde më të larta në garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, por njëkohësisht forcon detyrimet dhe sanksionet për shkeljet e ligjit përkundrajt çdo Kontrolluesi.

Në këtë kuadër, sugjerojmë që, në përmbajtje të nenit 2 “Përkufizime” duhet të përfshihet gjithashtu edhe përkufizimi i termit “të dhëna personale”, sipas përcaktimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke qenë se Memorandumi përveç Shtojcës 1 të dedikuar transferimit të të dhënave personale, përmban edhe një dispozitë të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale (neni 8) në brendësi të saj.

Më tej, në paragrafin e parë të Shtojcës 1, (Rregullimi i përcjelljes së të dhënave personale mes Institucioneve kompetente, sikurse në nenit 8 të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Administratave kompetente të Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë për mbrojtjen e të miturve shqiptarë të pashoqëruar të pranishëm në territorin e Republikës Italiane si dhe për bashkëpunimin në parandalimin dhe luftën ndaj fenomenit dhe veprave penale që lidhen me të), ku specifikohet baza ligjore, duhet të përfshihet gjithashtu edhe ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në cilësinë e kuadrit ligjor në fuqi, të aplikueshëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Sugjerojmë se duhet të përshtaten këto terma/përkufizime:

- Togfjalëshi, “Të dhënat e veçanta”, në Kreun I, germa “b” të zëvendësohet me “Të dhëna sensitive”.
- Termi “Trajtimi” në Kreun I, germa “e” të zëvendësohet me termin “Përpunim”.
- Termi “Përcjellja” në Kreun I, germa “f” të zëvendësohet me “Transmetim”.
- Togfjalëshi, “Shkelje e të dhënave personale” në Kreun I, germa “j” të zëvendësohet me “Cenim i të dhënave personale”.
- Togfjalëshi “Të drejtat e të interesuarve” në Kreun I, në pikën “m” të zëvendësohet me “Të drejtat e subjektit të të dhënave”.
- Togfjalëshi “E drejta për të përftuar informacion” në Kreun I, në pikën “m/i” të zëvendësohet me “E drejta për informim”.
- Togfjalëshi “E drejta për të bërë ndryshime” në Kreun I, në pikën “m/iii” të zëvendësohet me “E drejta për të kërkuar korrigjim”.
- Togfjalëshi “E drejta për të paraqitur kundërshti” në Kreun I, në pikën “m/v” të zëvendësohet me “E drejta për të kundërshtuar”.
- Togfjalëshi “E drejta e kufizimit të trajtimit” në Kreun I, në pikën “m/vi” të zëvendësohet me “E drejta për të kërkuar bllokim”.

Gjithashtu, vlerësojmë se, termi “Përpunimi”, sipas përkufizimit të paraqitur në Shtojcën 1, nuk është shterues në përmbajtjen e tij dhe duhet riformuluar duke mbajtur në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi, me qëllim zbërthimin e saktë të këtij koncepti.

Së fundi, me përshtatjen e terminologjisë së përdorur, Memorandumi vlerësohet i hartuar konform parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**